



**BULETINI PERIODIK I
PRAKTIKËS GJYQËSORE
PERIODIČNI BILTEN
SUĐSKE PRAKSE**



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUĐ
CONSTITUTIONAL COURT**

**TETOR-DHJETOR
OKTOBAR - DECEMBAR
2024**

IV

Buletini periodik i praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese

(Tetor-Dhjetor 2024)

Buletini periodik i praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese përmban përmbledhjen e aktgjykimeve dhe aktvendimeve me rëndësi dhe interes të veçantë, të cilat janë publikuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) gjatë periudhës së fundit tre (3) mujore.

Në këtë Buletin janë pasqyruar fillimisht përmbledhjet e aktgjykimeve që ndërlidhen me kërkesat institucionale, përderisa përmbledhja e aktgjykimeve në rastet individuale është renditur sipas pretendimeve të bazuara në nenet specifike të Kapitullit II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).

Buletini periodik i praktikës gjyqësore është një dokument që publikohet në baza periodike dhe është përgatitur vetëm për çështje informative. Përmbledhjet e pasqyruara në këtë Buletin përmbajnë esencën e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe konstatimit të Gjykatës dhe për këtë arsye çdo interpretim dhe analizë e tyre duhet bërë në dritën e Aktgjykimeve të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe uebfaqen e Gjykatës Kushtetuese:

www.gjk-ks.org

Për të pranuar Buletinin periodik të praktikës gjyqësore në postën tuaj elektronike, ju lutemi të regjistrohemi në uebfaqen e Gjykatës:

www.gjk-ks.org/publikimet/buletini-periodik

Vërejtje: Kushdo që dëshiron të kopjojë, përkthejë apo shfrytëzojë për qëllime të tjera të gjitha ose një pjesë të informacioneve të përmbajtura në Buletin, duhet të kontaktojë Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese për udhëzime të mëtejshme.

Periodični bilten sudske prakse Ustavnog suda

(Oktobar–Decembar 2024. godine)

Periodični bilten sudske prakse Ustavnog suda sadrži sažetke presuda i rešenja od posebnog značaja i interesa, koje je Ustavni sud Republike Kosovo (u daljem tekstu: Sud) objavio u posljednja tri (3) meseca.

U ovom Biltenu prvo su prikazani sažeci presuda u vezi sa institucionalnim zahtevima, dok je sažetak presuda u individualnim predmetima naveden u redosledu prema navodima zasnovanim na posebnim članovima Poglavlja II Ustava Republike Kosovo (u daljem tekstu: Ustav).

Periodični bilten sudske prakse je dokument koji se objavljuje periodično i pripremljen je samo u informativne svrhe. Sažeci prikazani u ovom Biltenu sadrže suštinu navoda podnosi-laca zahteva i nalaze Suda i stoga svako njihovo tumačenje i analiza mora biti urađeno u svetlu presuda objavljenih u Službenom listu Republike Kosovo i na sajtu Ustavnog suda:

www.gjk-ks.org

Da biste primali Periodični bilten sudske prakse na svoju adresu elektronske pošte, molimo vas registrujte se na internet stranici Suda:

<https://gjk-ks.org/sr/publikacije/periodicni-bilten/>

Napomena: Svako ko želi da kopira, pre-vede ili za druge svrhe koristi sve ili deo informacija sadržanih u ovom Biltenu treba da kontaktira Sekretarijat Ustavnog suda za dalja uputstva.

“Perandori Justinian” nr. 44, 10 000 Prishtinë

Tel: +383 (0) 38 60 61 62

Mob: +383(0) 45 200 595; +383(0) 45 200 576

Fax: +383(0) 38 60 61 70

Email: gjkata.kushtetuese@gjk-ks.org

©Gjykata Kushtetuese 2024

Tabela e përmbajtjes/Pregled sadržaja

I. Neni 45 [Të drejtat zgjedhore]

KO15/24, Parashtrues: *Institucioni i Avokatit të Popullit, Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 28 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.....8*

Bazuar në përcaktimet kushtetuese, përkundër që të gjithë janë të barabartë para ligjit, parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë dhe masat e tilla zbatohen, vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Kushtetuta nuk përcakton lartësinë, përkatësisht përqindjen e kësaj kuote ligjore, duke e deleguar këtë çështje në kompetencën e Kuvendit të Republikës, i cili ka autorizimet e plota që të avancojë përqindjen e kuotës që ndërlidhet me përfaqësimin gjinor në listat e subjekteve politike që garojnë në zgjedhje, gjithnjë në kontekst të një mase të nevojshme derisa të jetë arritur qëllimi i barazisë gjinore në Republikën e Kosovës dhe gjithnjë në pajtim me standardet e përcaktuara përmes mekanizmave të Këshillit të Evropës. Pesëdhjetë përqindëshi (50%) i synuar në Ligjin për Barazi Gjinore nuk është një kuotë ligjore për përfaqësim të detyrueshëm siç është tridhjetë përqindëshi (30%) i normuar në nenin 28 (Kuotat gjinore) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Thënë këtë, që të dyja janë ligje të miratuara nga Kuvendi i Republikës dhe i takon këtij të fundit, që gradualisht të arrijë qëllimet që vet ka përcaktuar përmes procesit ligjberës.

I. Çlan 45. [Pravo na izbor i učešće]

KO15/24, Podnosilac: *Institucija ombudsmana, ocena ustavnosti člana 28. Zakona br. 08/L-228 o opštim izborima u Republici Kosovo.....8*

Na osnovu ustavnih odredbi, uprkos tome što su svi jednaki pred zakonom, načela jednake pravne zaštite ne sprečavaju izricanje mera neophodnih za zaštitu i unapređenje prava pojedinaca i grupa koji su u neravnopravnom položaju i takve mere se sprovode samo dok se ne postigne cilj zbog koga su uvedene.

Ustav ne određuje visinu, odnosno procenat ove zakonske kvote, već delegira ovo pitanje u nadležnost Skupštine Republike, koja ima puna ovlašćenja da unapredi procenat kvote koja se odnosi na zastupljenost polova na listama političkih subjekata koji se takmiče na izborima, uvek u kontekstu neophodne mere dok se ne postigne cilj ravnopravnosti polova u Republici Kosovo i uvek u skladu sa standardima utvrđenim kroz mehanizme Saveta Evrope. Kvota od pedeset odsto (50%) kojoj se teži u Zakonu o rodnoj ravnopravnosti nije zakonska kvota za obaveznu zastupljenost, kao što je kvota od trideset odsto (30%) koja je normirana u članu 28. (Rodne kvote) Zakona o opštim izborima. Imajući to u vidu, oba zakona su usvojena od strane Skupštine Republike i na njoj je da postepeno ostvari ciljeve koje je sama utvrdila kroz zakonodavni proces.

II. Nenet 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe 110 [Këshilli Prokurorial]

KO283/23, Parashtrues: *Abelard Tahiri dhe 9 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-668 të 15 dhjetorit 2023, të*

Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkarkimin e z. Agron Beka nga pozita e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.....11

Kuvendi ka ushtruar rolin e tij ndërlidhur me anëtarët jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial, dhe ka shkarkuar një anëtar jo-prokuror bazuar në procedurën dhe bazat e shkarkimit sipas përcaktimeve të Ligjit për Këshillin Prokurorial, përfshirë mbi bazën e një arsytimi që nuk rezulton të jetë dukshëm arbitrarisht, dhe si rrjedhojë vendimi i kontestuar, nuk ka tejkaluar autorizimet kushtetuese dhe ligjore në kontekst të paragrafit 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe paragrafit 4 të nenit 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës.

II. Članovi 65. [Nadležnosti Skupštine] i 110. [Tužilački savet Kosova]

KO283/23, Podnosilac: *Abelard Tahiri i 9 drugih poslanika Skupštine Republike Kosovo*, ocena ustavnosti odluke br. 08-V-668 od 15. decembra 2023. godine Skupštine Republike Kosovo o razrešenju g. Agrona Beke sa pozicije člana Tužilačkog saveta Kosova.....11

Skupština je vršila svoju ulogu u odnosu na netužilačke članove Tužilačkog saveta i razrešila je jednog netužilačkog člana po postupku i osnovama za razrešenje prema odredbama Zakona o Tužilačkom savetu, uključujući i po osnovu obrazloženja koje se ne ispostavlja da je očigledno proizvoljno i kao rezultat toga, osporena odluka nije prekoračila ustavna i zakonska ovlašćenja u kontekstu stava 9. člana 65. [Nadležnosti Skupštine] i stava 4. člana 110. [Tužilački savet Kosova] Ustava.

III. Neni 30 [Të drejtat e të akuzuarit]

(i) E drejta për zgjedhje të mbrojtësit

KI11/24, Parashtrues: *Zekë Jasiqi*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit PN. nr. 1420/23 të 15 nëntorit 2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës.....14

E drejta për avokat mbrojtës nuk është e drejtë absolute dhe se kufizimi i kësaj të drejte, përkatësisht kufizimi i përzgjedhjes së mbrojtësit nga ana e të pandehurit i nënshtrohet dispozitave të zbatuara në sistemin ligjor përkatës, lidhur me atë se kush mund të jetë avokat në procedurë dhe se duhet të ketë arsye relevante dhe të mjaftueshme, të cilat përcaktojnë se një kufizim i tillë i kësaj të drejte është në të vërtetë në interes të drejtësisë.

III. Član 30. [Prava optuženog]

(i) Pravo na izbor branioca

KI11/24, Podnosilac: *Zekë Jasiqi*, ocena ustavnosti rešenja PN. br. 1420/23 Apelacionog suda Kosova od 15. novembra 2023. godine.....14

Pravo na branioca nije apsolutno pravo i ograničenje ovog prava, odnosno ograničenje izbora branioca od strane okrivljenog podleže odredbama koje se primenjuju u relevantnom pravnom sistemu, u vezi s tim ko može da bude advokat u postupku i da moraju da postoje relevantni i dovoljni razlozi koji određuju da je takvo ograničenje tog prava zaista u interesu pravde.

IV. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

(i) E drejta për qasje në gjykatë

KI117/23, Parashtrues: *Exclusive Sh.p.k.* Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [E. Rev. nr. 1/2023] të 17 janarit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës.....17

Interpretimi tejet formalist i rregullave procedurale nga ana e Gjykatës Supreme në lidhje me vlerën e objektit të kontestit, përkatësisht kufizimit *ratione valoris*, si kriter për lejueshmërinë e mjetit juridik - revizionit, rezultoi në kufizimin e së drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

KI84/22, Parashtruese: *Slavica Đorđević*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit Rev. nr. 170/2021 të Gjykatës Supreme, të 19 tetorit 2021.....19

Kufizimi i vendosur nga Gjykata Supreme për qasje në këtë gjykatë si rezultat i konstatimit të saj se revizioni i parashtruar nga parashtruesja e kërkesës ishte dorëzuar jashtë afatit, duke anashkaluar të drejtën e parashtrueses për pranimin e vendimit të Gjykatës së Apelit në gjuhën e saj amtare, përkundër faktit që bazuar në ligjin e aplikueshëm kjo ishte gjuha e zgjedhur në procedurë gjyqësore, ishte joproporcional dhe për pasojë, ka cenuar vetë thelbin e së drejtës për qasje në gjykatë.

KI43/24, Parashtrues: *Merita Visoka, Eroll Visoka dhe Melinda Visoka*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Rev. nr. 382/2023 të 17 tetorit 2023.....22

Dështimi i gjykatave të shkallës më të ulët për të përcaktuar vlerën e kontestit në procedurë gjyqësore ka rezultuar në pamundësinë e parashtruesve të kërkesës për të pasur qasje në Gjykatën Supreme, dhe si rezultat i një aplikimi tejet formalist të kufizimit *ratione valoris*, atyre iu është cenuar e drejta për qasje në gjykatë, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

KI49/23, Parashtrues: *Shaban Dulahu dhe të tjerët*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [ARJ-UZVP. nr. 109/2022] të Gjykatës Supreme, të 20 tetorit 2022.....24

Pamundësia për të adresuar objektin e kërkesëpadisë dhe pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtruesit e kërkesës nëpërmjet parashtrësive/mjeteve juridike, respektivisht nga ana e gjykatave të rregullta, dhe mosriparimi i shkeljes së kësaj të drejte nga gjykata e shkallës më të lartë përbën një të metë procedurale, e cila si rrjedhojë cenon vetë thelbin e së drejtës së parashtruesve të kërkesës për të marrë një përgjigje meritore në lidhje me çështjen e tyre.

(ii) E drejta për një vendim të arsyetuar

KI118/23, Parashtrues: *Shehide Muhadri*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Ac. nr. 530/2016] të 30 marsit 2023, të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës.....27

Gjykata e Apelit kishte adresuar pretendimet thelbësore të parashtrueses së kërkesës, duke iu përgjigjur konkretisht çështjes që ndërlidhej me konsistencën në vendimmarrje për çështjet e fitimit të pronësisë me mirëbesim nëpërmjet parashkrimit fitues dhe kishte dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse rastet të cilave iu ishte referuar parashtruesja e kërkesës në procedurë të rregullt para Gjykatës së Apelit, nuk përbënin praktikë gjyqësore dhe burim të së drejtës në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë me parashkrim fitues.

KI36/23, Parashtrues: *“DONA-IMPEX” Sh.p.k.*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [E. Rev. nr. 45/2021] të 10 nëntorit 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës.....30

Pjesa e arsytimit të Aktgjykimit të kontestuar, e cila rezulton të jetë në kundërshtim me vet dispozitivin, nuk rezulton të jetë çështje thjesht teknike, por reflekton mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor në kundërshtim me garancitë procedurale ndërlidhur me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

(iii) Parimi i kontradiktoritetit

KI105/24, Parashtrues: *Imrije Kadriu*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 2125/22, të 23 shkurtit 2024.....32

Mosnjoftimi i parashtrueses së kërkesës me përgjigjen në ankesë të ushtruar nga Komuna e Shtimes në Gjykatën e Apelit të Kosovës ka rezultuar në disavantazh të saj me palën kundërshtare, dhe për rrjedhojë është cenuar parimi i kontradiktoritetit procedural, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

IV. Član 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]

(i) Pravo na pristup sudu

KI117/23, Podnosilac: *Exclusive D.o.o.*, ocena ustavnosti rešenja [E. Rev. br. 1/2023] od 17. januara 2023. godine, Vrhovnog suda Kosova.....17

Veoma formalističko tumačenje proceduralnih pravila od strane Vrhovnog suda u pogledu vrednosti predmeta spora, odnosno ograničenja *ratione valoris*, kao kriterijuma za dozvoljenost pravnog sredstva - revizije, rezultiralo je ograničenjem prava podnosioca zahteva na pristup sudu, zagaranovanog članom 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava i članom 6. (Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima.

KI84/22, Podnositeljka: *Slavica Đorđević*, ocena ustavnosti rešenja Vrhovnog suda Rev. br. 170/2021 od 19. oktobra 2021. godine.....19

Ograničenje koje je Vrhovni sud uveo za pristup ovom sudu kao rezultat njegovog nalaza da je revizija koju je uložila podnositeljka zahteva podneta van roka, zaobilazeći pravo na podnositeljke zahteva da primi odluku Apelacionog suda na svom maternjem jeziku, uprkos činjenici da je na osnovu važećeg zakona to bio jezik izabran u sudskom postupku, bilo je nesrazmerno i samim tim povredilo samu suštinu prava na pristup sudu.

KI43/24, Podnosilac: *Merita Visoka, Eroll Visoka i Melinda Visoka*, ocena ustavnosti rešenja Rev. br. 382/2023 od 17. oktobra 2023. godine Vrhovnog suda Republike Kosovo.....22

Propust nižestepjenih sudova da utvrde vrednost spora u sudskom postupku rezultiralo je nemogućnošću podnosioca zahteva da imaju pristup Vrhovnom sudu i kao rezultat veoma formalističke primene ograničenja *ratione valoris*, povređeno im je pravo na pristup sudu, kao sastavni deo prava na pravično i nepristrasno suđenje, zagarantovanog članom 31. Ustava u vezi sa članom 6. EKLJP.

KI49/23, Podnosilac: *Shaban Dulahu i drugi*, ocena ustavnosti presude [ARJ-UZVP. br. 109/2022] Vrhovnog suda od 20. oktobra 2022. godine.....24

Nemogućnost da se reši predmet tužbenog zahteva i suštinski navodi koje su podnosioci zahteva pokrenuli putem podnesaka/pravnih sredstava, odnosno od strane redovnih sudova i propust da se otkloni povreda ovog prava od strane višeg suda predstavlja proceduralni nedostatak, čime se posledično krši sama suština prava podnosioca zahteva da dobiju meritorni odgovor u vezi sa svojim slučajem.

(ii) Pravo na obrazloženu odluku

KI118/23, Podnosilac: *Shehide Muhadri*, ocena ustavnosti presude [Ac. br. 530/2016] od 30. marta 2023. godine Apelacionog suda Republike Kosovo27

Apelacioni sud je sagledao suštinske navode podnositeljke zahteva, odgovorivši konkretno na pitanje koje se odnosilo na doslednost u odlučivanju o pitanjima sticanja svojine saveznom državinom na osnovu održaja i pružio dovoljno obrazloženje o tome zašto predmeti na koje se pozvala podnositeljka zahteva u redovnom postupku pred Apelacionim sudom, ne predstavljaju sudske praksu i izvor prava u vezi sa načinom sticanja svojine održajem.

KI36/23, Podnosilac: *“DONA-IMPEX” D.o.o.*, ocena ustavnosti presude [E. Rev. br. 45/2021] od 10. novembra 2022. godine Vrhovnog suda Kosova.....30

Za deo obrazloženja osporene presude za koji rezultira da je u suprotnosti sa samom izrekom, ne ispostavlja se da predstavlja čisto tehničko pitanje, već da odražava nepostojanje obrazložene sudske odluke u suprotnosti sa procesnim garancijama koje se odnose na pravo na pravično i nepristrasno suđenje zagarantovano članom 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava u vezi sa članom 6. (Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima.

(iii) Načelo kontradiktornosti

KI105/24, Podnosilac: *Imrije Kadriu*, ocena ustavnosti presude Ac. br. 2125/22 od 23. februara 2024. godine Apelacionog suda.....32

Neupoznavanje podnositeljke zahteva sa odgovorom na žalbu koji je Opština Štimlje dostavila Apelacionom sudu Kosova rezultiralo je njenim dovođenjem u nepovoljniji položaj u odnosu na protivnu stranu i usled toga je povređeno načelo procesne kontradiktornosti, kao sastavni deo prava na pravično i nepristrasno suđenje, zagarantovanog članom 31. Ustava u vezi sa članom 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima.

I. Neni 45 [Të drejtat zgjedhore]

KO15/24, Parashtrues: *Institucioni i Avokatit të Popullit*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 28 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

Kushtetuta nuk përcakton lartësinë, përkatësisht përqindjen e kësaj kuote ligjore, duke e deleguar këtë çështje në kompetencën e Kuvendit të Republikës, i cili ka autorizimet e plota që të avancojë përqindjen e kuotës që ndërlihet me përfaqësimin gjinor në listat e subjekteve politike që garojnë në zgjedhje, gjithnjë në kontekst të një mase të nevojshme derisa të jetë arritur qëllimi i barazisë gjinore në Republikën e Kosovës dhe gjithnjë në pajtim me standardet e përcaktuara përmes mekanizmave të Këshillit të Evropës.

- Nuk ka shkelje të të drejtave kushtetuese

Ligji i kontestuar

Neni 28 (Kuotat gjinore) i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcakton që (i) në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30%) përqind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30%) përqind janë femra, me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku një herë në secilin grup prej tre (3) kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë; (ii) kjo dispozitë nuk aplikohet te listat e përbëra nga një apo dy kandidatë; dhe (iii) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndanë fonde publike shtesë, në vlerën një përqind (1%) të shumës së përgjithshme të alokuar për subjektin politik, për secilin mandat të fituar nga gratë mbi kuotën tridhjetë përqind (30%) në momentin e certifikimit dhe që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve planifikon pas çdo palë zgjedhje buxhet shtesë për këtë qëllim.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

Avokati i Popullit pretendon që (i) vendosja me ligj e kuotës prej tridhjetë përqind (30%) për secilën gjini, përbën paragjykim të pajustificuar dhe për ligj trajtimin e pabarabartë, duke marrë parasysh se përqindja gjinore është pothuajse

I. Član 45. [Pravo na izbor i učešće]

KO15/24, Podnosilac: *Institucija ombudsmana*, ocena ustavnosti člana 28. Zakona br. 08/L-228 o opštim izborima u Republici Kosovo

Ustav ne određuje visinu, odnosno procenat ove zakonske kvote, već delegira ovo pitanje u nadležnost Skupštine Republike, koja ima puna ovlašćenja da unapredi procenat kvote koja se odnosi na zastupljenost polova na listama političkih subjekata koji se takmiče na izborima, uvek u kontekstu neophodne mere dok se ne postigne cilj ravnopravnosti polova u Republici Kosovo i uvek u skladu sa standardima utvrđenim kroz mehanizme Saveta Evrope.

- Nema povrede ustavnih prava

Osporeni zakon

Članom 28. (Rodne kvote) Zakona br. 08/L-228 o opštim izborima utvrđeno je (i) da se na listi kandidata svakog političkog subjekta nalaze najmanje trideset odsto (30%) muškaraca i najmanje trideset odsto (30%) žena, sa po jednim kandidatom svakog pola, uključeni najmanje jednom u svaku grupu od tri (3) kandidata, počevši od prvog kandidata na listi; (ii) da se ova odredba ne primenjuje na liste koje se sastoje od jednog ili dva kandidata; i (iii) da Centralna izborna komisija izdvaja dodatna javna sredstva, u iznosu od jedan odsto (1%) od ukupnog iznosa dodeljenog političkom subjektu, za svaki mandat koji žene osvoje preko kvote od trideset odsto (30%) u trenutku overavanja i da Centralna izborna komisija planira dodatni budžet za ovu svrhu nakon svakih izbora.

Navodi podnosioca zahteva

Ombudsman tvrdi (i) da utvrđivanje zakonske kvote od trideset odsto (30%) za svaki rod predstavlja neopravdano prejudiciranje i ozakonjuje nejednako postupanje, s obzirom da je procenat polova skoro pedeset odsto (50%)

pesëdhjetë përqind (50%) me pesëdhjetë përqind (50%) mes “*meshkujve dhe femrave*”; (ii) në praktikën zgjedhore “*nuk ka ngjarë që subjektet politike të kenë dërguar për certifikim listat e kandidatëve me nga pesëdhjetë përqind (50%) meshkuj dhe femra*”; dhe (iii) ky përcaktim, po ashtu është në kundërshtim me frymën e barazisë gjinore të parashikuar me nenin 5 (Masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore) të Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

Vlerësimi i Gjykatës

Thelbi i çështjes së ngritur para Gjykatës, është përputhshmëria me Kushtetutën e nenit 28 (Kuotat gjinore) të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, përkatësisht vlerësimi nëse përcaktimi i kuotës ligjore prej së paku tridhjetë përqind (30%) të përfaqësimit të secilës gjini në listën e subjekteve politike që garojnë në zgjedhje, cenon të drejtat zgjedhore të përcaktuara me Kushtetutë. Aktgjykimi së pari dhe ndërlidhur me përqindjen e kuotës gjinore në listat zgjedhore të subjekteve politike, vë theks në faktin që përderisa Kushtetuta mundëson vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë, ajo nuk përcakton përqindjen e kësaj kuote, duke i lënë hapësirën e nevojshme pushtetit legjislativ, përkatësisht Kuvendit të Republikës së Kosovës për të përcaktuar këtë përqindje, në përputhje me detyrimet pozitive të shtetit për të siguruar barazinë gjinore dhe e cila, pasi të jetë caktuar duhet të zbatohet me përpikëri. Aktgjykimi gjithashtu sqaron, që bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përcaktimi i kësaj kuote si masë e përkohshme dhe e nevojshme derisa të jetë arritur barazia gjinore, është çështje e politikës publike dhe e cila, i takon pushtetit legjislativ. Sipas sqarimeve të dhëna, nuk është në kompetencën e Gjykatës të përcaktojë lartësinë dhe/ose përqindjen e kësaj kuote ligjore, por Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka autorizimet e plota që të avancojë përqindjen e kuotës së lartcekur që ndërlidhet me përfaqësimin gjinor në listat e subjekteve politike që garojnë në zgjedhje, gjithnjë në kontekst të një mase të nevojshme derisa të jetë arritur qëllimi i barazisë gjinore në Republikën e

prema pedeset odsto (50%) između “*muškaraca i žena*”; (ii) da se u izbornoj praksi “*nije desilo da su politički subjekti slali na sertifikaciju liste kandidata sa pedeset odsto (50%) muškaraca i žena*”; i (iii) da je ova odredba takođe u suprotnosti i sa duhom ravnopravnosti polova predviđenim članom 5. (Opšte mere za sprečavanje rodne diskriminacije i obezbeđenje rodne ravnopravnosti) Zakona br. 05/L-020 o ravnopravnosti polova.

Ocena Suda

Sušтина pitanja koje je pokrenuto pred Sudom predstavlja saglasnost člana 28. (Rodne kvote) Zakona o opštim izborima sa Ustavom, odnosno ocena da li utvrđivanje zakonske kvote od najmanje trideset odsto (30%) zastupljenosti svakog pola na listi političkih subjekata koji se takmiče na izborima, narušava izborna prava koja su utvrđena Ustavom.

Presuda prvo i u vezi sa procentom rodne kvote na izbornim listama političkih subjekata stavlja naglasak na činjenicu da, iako Ustav omogućava uvođenje potrebnih mera za zaštitu i unapređenje prava pojedinaca i grupa koji se nalaze u nejednakom položaju, on utvrđuje procenat te kvote, ostavljajući neophodan prostor zakonodavnoj vlasti, odnosno Skupštini Republike Kosovo da utvrdi ovaj procenat u skladu sa pozitivnom obavezom države da osigura rodnu ravnopravnost, koji se, kada je utvrđen, mora precizno sprovoditi. Presuda, takođe, objašnjava da na osnovu sudske prakse Evropskog suda za ljudska prava utvrđivanje ove kvote kao privremene i neophodne mere dok se ne postigne rodna ravnopravnost predstavlja pitanje javne politike, koje pripada zakonodavnoj vlasti. Prema datim objašnjenjima, nije u nadležnosti Suda da utvrdi visinu i/ili procenat ove zakonske kvote, već Skupština Republike Kosovo ima puna ovlašćenja da unapredi procenat gore navedene kvote koja se odnosi na rodnu zastupljenost na listama političkih subjekata koji se takmiče na izborima, uvek u kontekstu neophodne mere, dok se ne postigne cilj rodne ravnopravnosti u Republici Kosovo i uvek u skladu sa standardima

Kosovës dhe gjithnjë në pajtim me standardet e përcaktuara përmes mekanizmave të Këshillit të Evropës e të shtjelluara në këtë Aktgjykim.

Së dyti, dhe ndërlidhur me qëllimin e synuar të përfaqësimit prej pesëdhjetë përqind (50%) të vendosur në Ligjin për Barazi Gjinore, Aktgjykimi ndër të tjera, thekson që Kuvendi si ligjvënës nuk e ka formuluar përqindjen për pesëdhjetë përqind (50%) si një kuotë obligative ligjore por, e ka formuluar në formën e një aspirate drejt arritjes së qëllimit dhe përcaktimit kushtetues për barazi gjinore në Republikën e Kosovës. Më saktësisht dhe sipas sqarimeve të dhëna, pesëdhjetë përqindëshi (50%) i synuar në Ligjin për Barazi Gjinore nuk është një kuotë ligjore për përfaqësim të detyrueshëm siç është tridhjetë përqindëshi (30%) i normuar në nenin 28 (Kuotat gjinore) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Thënë kështu, që të dyja janë ligje të miratuara nga Kuvendi i Republikës dhe i takon këtij të fundit, që gradualisht të arrijë qëllimet që vet ka përcaktuar përmes procesit ligjbërës.

Së treti, dhe ndërlidhur me standardin e nevojshëm të renditjes zinxhir të kandidatëve nga gjinitë përkatëse, Aktgjykimi thekson që neni 28 (Kuotat gjinore) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, saktëson që lista e kandidatëve të secilit subjekt politik, duhet të përfshijë nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku një herë në secilin grup prej tre (3) kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë dhe që një rregullim i tillë, është i bazuar edhe në standardet e aplikueshme ndërkombëtare.

Përfundimi

Gjykata konstatoi se neni 28 (Kuotat gjinore) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk është në kundërshtim me të drejtën për t'u zgjedhur të garantuar me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës.

koji su uspostavljeni kroz mehanizme Saveta Evrope, koji su razrađeni u ovoj presudi.

Drugo, u vezi sa ciljem kojem se teži, a to je zastupljenost od pedeset odsto (50%) koja je utvrđena u Zakonu o rodnoj ravnopravnosti, presuda, između ostalog, navodi da Skupština kao zakonodavac nije formulisala procesnat od pedeset odsto (50%) kao obaveznu zakonsku kvotu, već ju je formulisao u obliku težnje ka postizanju ustavnog cilja i opredeljenja za rodnu ravnopravnost u Republici Kosovo. Tačnije i prema datim objašnjenjima, kvota od pedeset odsto (50%) kojoj se teži u Zakonu o rodnoj ravnopravnosti nije zakonska kvota za obaveznu zastupljenost, kao što je kvota od trideset odsto (30%) koja je normirana u članu 28. (Rodne kvote) Zakona o opštim izborima. Imajući to u vidu, oba zakona su usvojena od strane Skupštine Republike i na njoj je da postepeno ostvari ciljeve koje je sama utvrdila kroz zakonodavni proces.

Treće, a u vezi sa neophodnim standardom ulančavanja kandidata iz odgovarajućih rodova, presuda naglašava da član 28. (Rodne kvote) Zakona o opštim izborima precizira da lista kandidata svakog političkog subjekta mora da sadrži po jednog kandidata svakog roda, uključujući i najmanje jednom u svakoj grupi od tri (3) kandidata, računajući od prvog kandidata na listi i da je takvo uređenje zasnovano i na važećim međunarodnim standardima.

Zaključak

Sud je utvrdio da član 28. (Rodne kvote) Zakona o opštim izborima nije u suprotnosti sa pravom da se bude biran koje je zagarantovano članom 45. [Pravo na izbor i učešće] Ustava.

II. Neneti 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe 110 [Këshilli Prokurorial]

KO283/23, Parashtrues: *Abelard Tahiri dhe 9 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-668 të 15 dhjetorit 2023, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkarkimin e z. Agron Beka nga pozita e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës

Kuvendi ka ushtruar rolin e tij ndërlidhur me anëtarët jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial, dhe ka shkarkuar një anëtar jo-prokuror bazuar në procedurën dhe bazat e shkarkimit sipas përcaktimeve të Ligjit për Këshillin Prokurorial, përfshirë mbi bazën e një arsytimi që nuk rezulton të jetë dukshëm arbitrar, dhe si rrjedhojë vendimi i kontestuar, nuk ka tejkaluar autorizimet kushtetuese dhe ligjore në kontekst të paragrafit 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe paragrafit 4 të nenit 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës.

- Nuk ka shkelje e të drejtave kushtetuese

Vendimi

Përmes Vendimit [nr. 08-V-668] të 15 dhjetorit 2023 të Kuvendit të Republikës së Kosovës z. Agron Beka ishte shkarkuar nga pozita e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Shkarkimit të tij, i kishte paraprirë Rekomandimi [nr. 08/4446/Do-1994] i 28 shtatorit 2023 i Komisionit për Legjislacionin, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, përmes të cilit ky i fundit i kishte rekomanduar Kuvendit, shkarkimin e z. Beka nga pozita e anëtarit jo-prokuror, duke u bazuar në gjetjet e këtij komisioni parlamentar. Siç është reflektuar dhe sqaruar gjerësisht në Aktgjykimin e publikuar, në Rekomandimin e lartcekur të Komisionit për Legjislacionin, janë listuar arsyet në të cilat ky i fundit e bazon rekomandimin e tij drejtuar Kuvendit për shkarkimin e z. Beka nga pozita e anëtarit jo-prokuror të Këshillit Prokurorial, duke vlerësuar se veprimet përkatëse përbëjnë shkelje të ligjit, përkatësisht nënparagrafit 2.2 të paragrafit 2 të nenit 13 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili në mënyrë specifike

II. Çlanovi 65. [Nadležnosti Skupštine] i 110. [Tužilački savet]

KO283/23, Podnosilac: *Abelard Tahiri i 9 drugih poslanika Skupštine Republike Kosovo*, ocena ustavnosti odluke br. 08-V-668 od 15. decembra 2023. godine Skupštine Republike Kosovo o razrešenju g. Agrona Beke sa pozicije člana Tužilačkog saveta Kosova

Skupština je vršila svoju ulogu u odnosu na netužilačke članove Tužilačkog saveta i razrešila je jednog netužilačkog člana po postupku i osnovama za razrešenje prema odredbama Zakona o Tužilačkom savetu, uključujući i po osnovu obrazloženja za koje se ne ispostavlja da je očigledno proizvoljno i kao rezultat toga, osporena odluka nije prekoračila ustavna i zakonska ovlašćenja u kontekstu stava 9. člana 65. [Nadležnosti Skupštine] i stava 4. člana 110. [Tužilački savet Kosova] Ustava.

- Nema povrede ustavnih prava

Odluka

Odlukom [br. 08-V-668] Skupštine Republike Kosovo od 15. decembra 2023. godine, razrešen je g. Agron Beka sa pozicije člana Tužilačkog saveta Kosova. Njegovom razrešenju je prethodila preporuka [br. 08/4446/Do-1994] Komisije za zakonodavstvo, mandate, imunitet, Poslovnik Skupštine i nadzor Agencije protiv korupcije od 28. septembra 2023. godine, kojom je ta komisija preporučila Skupštini razrešenje g. Beke sa pozicije netužilačkog člana, na osnovu nalaza ove parlamentarne komisije. Kao što je opširno prikazano i objašnjeno u objavljenoj presudi, u gore navedenoj preporuci Komisije za zakonodavstvo su navedeni razlozi na kojima ta komisija zasniva svoju preporuku upućenu Skupštini za razrešenje g. Beke sa pozicije netužilačkog člana Tužilačkog saveta, ocenjujući da predmetne radnje predstavljaju povredu zakona, odnosno podstava 2.2 stava 2. člana 13. (Završetak mandata) Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom savetu Kosova, u

thekson se anëtari i Këshillit Prokurorial shkarkohet në rast se “2.2 ushtron funksionin në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij”.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

Parashtruesit e kërkesës para Gjykatës kontestuan kushtetutshmërinë e Vendimit [nr. 08-V-668] të 15 dhjetorit 2023 të Kuvendit, duke pretenduar, ndër të tjera, që i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafët 1 dhe 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], si dhe paragrafët 1 dhe 4 të nenit 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës. Sipas parashtruesve të kërkesës, në esencë, Kuvendi ka tejkaluar autorizimet e tij kushtetuese sepse nuk ka kompetencë që të ndërpresë mandatin kushtetues të një anëtari të Këshillit Prokurorial.

Vlerësimi i Gjykatës

Në kontekst të çështjeve të mësipërme, Aktgjykimi fillimisht vë theks në faktin që, rrethanat dhe pretendimet e lartcekura, ndër të tjera, kanë ngritur çështje si në vijim: (i) nëse Kuvendi, ka autorizimin që të ndërpresë mandatin kushtetues të një anëtari jo-prokuror të Këshillit Prokurorial; dhe (ii) nëse ndërprerja e mandatit në rrethanat e rastit konkret, ka rezultuar në cenimin e pavarësisë së Këshillit Prokurorial. Në kontekstin e parimeve që burojnë nga analiza e dispozitave kushtetuese, Aktgjykimi, ndër të tjera, sqaron që në kontekst të ushtrimit të funksioneve të Kuvendit lidhur me institucionet e pavarura kushtetuese në kuadër të kapitullit VII [Sistemi i Drejtësisë] të Kushtetutës, rëndësi të veçantë ka ndërveprimi i Këshillit Prokurorial me Kuvendin, sipas përcaktimeve të neneve 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës, të cilat, në esencë, përcaktojnë ushtrimin e kompetencës së Kuvendit për të përcaktuar përbërjen e Këshillit Prokurorial dhe për të zgjedhur anëtarët e Këshillit Prokurorial, gjithnjë në funksion të ruajtjes së pavarësisë së plotë të këtij Këshilli në ushtrimin e funksioneve të tij kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës

kome je izričito navedeno da se član Tužilačkog saveta razrešava u slučaju da “2.2 vrši svoju funkciju suprotno svojim dužnostima i odgovornostima”.

Navodi podnosilaca zahteva

Podnosioci zahteva su pred Sudom osporili ustavnost odluke [br. 08-V-668] Skupštine od 15. decembra 2023. godine, navodeći, između ostalog, da je doneta u suprotnosti sa stavom 1. člana 4. [Oblik vladanja i podela vlasti], stavovima 1. i 2. člana 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje], članom 32. [Pravo na pravno sredstvo], članom 54. [Sudska zaštita prava], kao i stavovima 1. i 4. člana 110. [Tužilački savet Kosova] Ustava. Prema navodima podnosilaca zahteva, u suštini, Skupština je prekoračila svoja ustavna ovlašćenja jer nema ovlašćenje da članu Tužilačkog saveta prekine ustavni mandat.

Ocena Suda

U kontekstu gore navedenih pitanja, presuda prvo naglašava činjenicu da su gore navedene okolnosti i tvrdnje, između ostalog, pokrenule i sledeća pitanja: (i) da li Skupština ima ovlašćenje da prekine ustavni mandat netužilačkom članu Tužilačkog saveta; i (ii) da li je prestanak mandata u okolnostima konkretnog slučaja doveo do povrede nezavisnosti Tužilačkog saveta. U kontekstu načela koja proizilaze iz analize ustavnih odredbi, presuda, između ostalog, pojašnjava da je u kontekstu vršenja funkcija Skupštine koje se odnose na nezavisne ustavne institucije u okviru Poglavlja VII [Pravosudni sistem] Ustava, interakcija Tužilačkog saveta sa Skupštinom od posebnog značaja, prema odredbama člana 65. [Nadležnosti Skupštine] i 110. [Tužilački savet Kosova] Ustava i koje, u suštini, utvrđuju vršenje nadležnosti Skupštine da utvrđuje sastav Tužilačkog saveta i bira članove Tužilačkog saveta, uvek u funkciji održavanja potpune nezavisnosti ovog Saveta u vršenju njegovih ustavnih funkcija, kako je definisano u stavu 1. člana 110. [Tužilački savet Kosova] Ustava i istovremeno, poštujući podelu i ravnotežu vlasti, kako je definisano u

dhe njëkohësisht, të respektimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve] të Kushtetutës. Aktgjykimi, tutje rikujton se parimet lidhur me pavarësinë e Këshillit Prokurorial, nërveprimin e këtij të fundit me Kuvendin në funksion të ruajtjes së pavarësisë së plotë të Këshillit Prokurorial në ushtrimin e funksioneve të tij kushtetuese, si dhe sigurinë e mandateve të anëtarëve të Këshillit Prokurorial, janë përcaktuar nga Gjykata përmes Aktgjykimit të 24 marsit 2023, në rastet KO100/22 dhe KO101/22 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial. Në kontekst të rrethanave specifike të këtij rasti, Aktgjykimi sqaron që, përkundër faktit që Kushtetuta, përmes paragrafit 4 të nenit 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të saj, ka përcaktuar që përbërja e Këshillit Prokurorial, si dhe dispozitat, ndër të tjera, ndërlidhur me shkarkimin përcaktohen me ligj, kjo kompetencë e Kuvendit, duhet të ushtrohet gjithnjë në përputhje me paragrafin 1 të nenit 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës, përmes të cilit garantohet pavarësia e plotë e Këshillit Prokurorial dhe e cila kompetencë nuk mund të pakësohet përmes dispozitave ligjore. Megjithatë dhe sipas sqarimeve të dhëna, në kontekst të shkarkimit të anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial, nga përmbajtja e paragrafit 10 të nenit 10 (Procedura e propozimit, zgjedhjes dhe e shkarkimit të anëtarëve që zgjedhën nga Kuvendi) të Ligjit për Këshillin Prokurorial, rezultojnë dy forma të ndryshme të propozimit në Kuvend për shkarkim të anëtarit jo-prokuror të Këshillit Prokurorial, respektivisht: (i) përmes propozimit nga Komisioni përkatës i Kuvendit, i cili ka për detyrë të shqyrtojë dhe vlerësojë performancën ose sjelljen e anëtarit jo-prokuror dhe, në rast të propozimit për shkarkim, i njëjti i dorëzohet Kuvendit për votim; si dhe (ii) përmes propozimit të vet Këshillit Prokurorial, kur i njëjti vlerëson se një anëtar jo-prokuror nuk e përmbush detyrën e tij në përputhje me përgjegjësitë ose nëse ka vepruar në mënyrë të papërshtatshme, të cilin propozim e dorëzon në Kuvend ku i nënshtrohet votimit, si në rastin e parë. Në rastin konkret, propozimi për shkarkim i anëtarit përkatës jo-prokuror të Këshillit, vjen nga Komisioni përkatës i Kuvendit, respektivisht nga Komisioni

stavu 1. člana 4. [Oblik vladanja i podela vlasti] Ustava. U presudi se dalje podseća da su načela koja se odnose na nezavisnost Tužilačkog saveta, njegovu interakciju sa Skupštinom u cilju očuvanja potpune nezavisnosti Tužilačkog saveta u vršenju njegovih ustavnih funkcija, kao i sigurnosti mandata članova Tužilačkog saveta, Sud utvrdio presudom od 24. marta 2023. godine, u slučajevima KO100/22 i KO101/22 u vezi sa ocenom ustavnosti Zakona br. 08/L-136 o izmenama i dopunama Zakona o Tužilačkom savetu. U kontekstu specifičnih okolnosti ovog slučaja, u presudi je pojašnjeno da je, uprkos činjenici da je Ustavom, stavom 4. njegovog člana 110. [Tužilački savet Kosova], utvrđeno da su sastav Tužilačkog saveta, kao i odredbe, između ostalog, koje se odnose na razrešenje, uređene zakonom, ova nadležnost Skupštine mora uvek vršiti u skladu sa stavom 1. člana 110. [Tužilački savet Kosova] Ustava, kojim se garantuje potpuna nezavisnost Tužilačkog saveta i čija nadležnost se ne može umanjiti zakonskim odredbama. Međutim, a prema datim pojašnjenjima, u kontekstu razrešenja netužilačkih članova Tužilačkog saveta, iz sadržaja stava 10. člana 10. (Postupak za predlaganje, izbor i razrešenje članova, koje bira Skupština) Zakona o Tužilačkom savetu, rezultiraju dva različita oblika predloga Skupštini za razrešenje netužilačkog člana Tužilačkog saveta, odnosno: (i) predlog relevantne skupštinske komisije, koja ima zadatak da razmotri i oceni učinak ili ponašanje netužilačkog člana i, u slučaju predloga za razrešenje, isti se podnosi Skupštini na glasanje; kao i (ii) sopstveni predlog Tužilačkog saveta, kada isti oceni da netužilački član ne ispunjava svoju dužnost u skladu sa nadležnošću ili ako je postupio nedolično, koji predlog podnosi Skupštini gde podleže glasanju, kao i u prvom slučaju. U konkretnom slučaju, predlog za razrešenje relevantnog netužilačkog člana Saveta dolazi od nadležne skupštinske komisije, odnosno od Komisije za zakonodavstvo, kao rezultat nalaza navedenih u gore navedenoj preporuci. U presudi se pojašnjava da je mogućnost razrešenja netužilačkog člana Tužilačkog saveta, od strane Skupštine, na predlog nadležne Komisije, izričito

për Legjislacion si rezultat i gjetjeve të specifikuara në rekomandimin e lartcekur. Aktgjykimi sqaron, që mundësia e shkarkimit të një anëtari jo-prokuror të Këshillit Prokurorial, nga Kuvendi, pas propozimit të Komisionit përkatës, është papaparë shprehimisht në Ligjin e aplikueshëm për Këshillin Prokurorial.

Përfundimi

Gjykata konstatoi se Vendimi [nr. 08-V-668] i 15 dhjetorit 2023 i Kuvendit, nuk është në kundërshtim me paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] si dhe paragrafin 4 të nenit 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës.

III. Neni 30 [Të drejtat e të akuzuarit]

KI11/24, Parashtrues: *Zekë Jasiqi*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit PN. nr. 1420/23 të 15 nëntorit 2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës

E drejta për avokat mbrojtës nuk është e drejtë absolute dhe se kufizimi i kësaj të drejte, përkatësisht kufizimi i përzgjedhjes së mbrojtësit nga ana e të pandehurit i nënshtrohet dispozitave të zbatuara në sistemin ligjor përkatës, lidhur me atë se kush mund të jetë avokat në procedurë dhe se duhet të ketë arsye relevante dhe të mjaftueshme, të cilat përcaktojnë se një kufizim i tillë i kësaj të drejte është në të vërtetë në interes të drejtësisë.

- Nuk ka shkelje të të drejtave kushtetuese

Faktet

Parashtruesi i kërkesës kontestoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [PN. nr. 1420/23] të 15 nëntorit 2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës që ndërlidhet me kallëzimin penal [2018-KE-262] të parashtruar nga Prokuroria për Krime të Rënda në Prishtinë kundër parashtruesit të kërkesës si dhe personave I.O., I.B, A.T., M.M., R.H.,E. L., dhe S.N., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale (i) “fajdeja” nga neni 343 (Fajdeja) në lidhje me nenin 31 (Bashkërkyerja) të Kodit Penal nr. 04/082 të Republikës së Kosovës; (ii) “detyrimi” nga neni 340 (Detyrimi) i Kodit Penal; dhe (iii) “mashtrimi” nga

predvidhena zakonom koji se primenjuje za Tužilački savet.

Zaključak

